



## **SHFMU "17 SHKURTI" GLOGOVÇ**

### **HISTORIKU I SHFMU "17 SHKURTI" NE GLOGOVÇ**

Shkolla fillore e mesme e ulët - SHFMU "17 Shkurti" ne fshatin Glogovc ka fillur punen si shkolle e pavarur ne vitin shkollor 2015/2016, pas ndarjes nga shkolla amë "Emin Duraku" ne Banulle-Glogovc.

Historiku i kësaj shkolle daton qysh para luftës së dytë botrore por për shkak të mungesës së dokumentacionit ka pak ose fare të dhëna në formë të shkruar për punën që është bërë në shkollën e Glogovcit deri në vitin 1945. Menjëherë pas luftës së dytë botrore ka filluar nga puna shkolla në fshatin Glogovc (si paralele e ndarë e shkollës së qytetit të Lipjanit), fillimishtë në mejtepin e gjamisë së Glogovcit për të vazhduar më vonë në këtë lokacion dhe ne lokacionin e shkollës që ka qënë në oborrin e shkollës së sotme në fshatin Glogovc. Shkolla e Glogovcit ka vazhduar të punoj në këto dy lokacione paralelishtë (për shkak të numrit të nxënësve) deri në vitin shkollor 1962/1963 kur nxënësit e kësaj shkolle sikurse edhe nxënësit e shkollave përreth kanë lëvizur në objektin e ri shkollor të asaj kohe (Shkolla filllore "Emin Duraku" në Glogovc der ne vitet e 70-ta të shekullit të kaluar e më vonë e quajtur Shkolla Fillore "Emin Duraku" Banull - Glogovc (e ndërtuar mes fshatrave Glogovc, Banull dhe Gumnasell.

Përveq nxënësve të këtyre tri fshatrave (të lartpërmendura) në këtë shkollë kanë ndjekur mësimet edhe nxënësit e fshatrave të Qollapek (I- VIII), Rubovci i Vogël, Rubovci i Madh, Kojksa, Llugaxhia (V – VIII)

Pas ndertimit te objekteve te reja shkollore ne fshatrat Glogovc, Banull dhe Bujari me vendim te Ministrise se Arsimit, Shkences dhe Teknologjise se Republikes se Kosoves, shkolla ne Glogovc është pavaruar.

Momentalishtë ky objekt shkollor ka 10 klasë mësimi dhe një kabinet (Fizikë, Kimi dhe Biologji) si dhe ka dhoma ndihmëse (dhoma e kaldase, dy miniklasë, sallën e arsimtarëve dhe një aneks dhomë afër sallës së arsimtarëve që mundë të përdoret apo funksionalizohet si kabinet i TiK-ut.

Mësimi në shkollën tonë organizohet vetëm në një ndrrim në kushtë shumë të mira. Numri i nxënësve nëpër klasë variron (nga 9 nxënës që ka klasa e IV me maksimum 24 nxënës që ka klasa e III-të). Pra momentalishtë (viti shkollor 2020/2021) shkolla ka 145 nxënës duke përfshirë edhe parashkollorët (8 nxënës – parashkollor; 13 nxënës – klasa e I-rë, 17 nxënës klasa e dytë, 24 nxënës klasa e III-të, 9 nxënës klasa e IV-të, 12 nxënës klasa e V-të, 19 nxënës klasa e VI-të, 15 nxënës klasa e VII-të, 15 nxënës klasa e VIII-të dhe 13 nxënës klasa e IX-të.